



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM  
NR 12 DATË 28.02.2022

**MBI KORIGJIMIN E VKB NR 63 DATË 11.10.2021 “MBI MIRATIMIN E PROCEDURËS SË SHPRONËSIMIT PËR OBJEKTIN 1K(shtesë anësore), E PALLATIT ME Nr Pas 2/951 ZK 3682,MIRATIMI I VLERËS PREJ 605624 LEKË ME TVSH BAZUAR NË SITUACIONIN PËRFUNDIMTAR HARTUAR SIPAS LIGJIT TË SHPRONËSIMEVE NË LAGJEN 18 TETORI PËR ZBATIMIN E INVESTIMIT**

Këshilli Bashkiak Dimal në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, bazuar në materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 53, 54 55 Ligji Nr 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimt dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Udhëzimin Nr 4 datë 30.09.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, VKM Nr 89 datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr 401 datë 23.10.1989 “Për miratimin e normave të reja të amortizimit”, VKB Nr 63 datë 11.10.2021 “Mbi miratimin e fillimit të procedurës së shpronësimt për objektin 1k (shtesë anësore) e palatit me Nr Pas 2/591 ZK 3682, Miratimi i vlerës prej 605624 lekë me tvsh, bazuar në situacionin përfundimtar, hartuar sipas ligjit të shpronësimt dhe VKB Nr 82 datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2022-2024 dhe miratimin e Buxhetit të detajuar për vitin 2022” dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë

**VENDOSI**

**Me 15 vota PRO nga 15 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë:**

1. Të miratojë korigjim e vlerës për shpronësimt të objektit në pronësi të Z. Rexhep Koroni, nga masa 605624 lekë e miratuar me VKB Nr 63 datë 11.10.2021, në vlerën 691124 lekë për të vazhduar procedurën e shpronësimt për interes publik

2.Të miratojë korrigjimin e vlerës për shpronësim të pjesshëm të objektit 1k në pronësi të Z.Shkëlqim Veis Plaku,në masën 61611 lekë,për të vazhduar procedurën e shpronësimit për interes public

3.Transferimi i shumës monetare në llogari bankare të shtetasve do të kryehet pas paraqitjes së certifikatës së pronësisë së korigjuar me sipërfaqen ne re të objekteve.

4.Ngarkohet për zbatim të këtij Vendimi Kryetari i Bashkisë,Adminsitrata e Bashksië

5.Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve në nenit 55,pika 6 të Ligjit 139/2015”Për Vetëqeverisjes Vendore”,i ndryshuar.

